



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700778/7

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave për planifikimin e caktimit të gjykimit të çështjes administrative me Nr.31018-04914-86-2016 akti, datë 29.09.2016, midis Paditësit Q. M. dhe të Paditurit D.R.S.SH. Shkodër.*

Drejtuar : **Z.Kastriot SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 22.06.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi Q. M. nga Shkodra, ankohet për zvarritje gjyqimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore në gjykimin e një çështje administrative kundra D.R.S.SH. Shkodër në lidhje me pezullimin e dhënies së pensionit të pleqërisë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezultoi se :

Ndaj vendimit gjyqësor të Gjykatës Administrative të shkallës së parë Shkodër palët janë ankuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe dosja tani ndodhet e regjistruar për gjykim me Nr.31018-04914-86-2016 akti, datë 29.09.2016, dhe në bazë të shortit elektronik të hedhur është caktuar Z.Arjan QAFA si Gjyqtar për shqyrtimin e saj, i cili nga ana e tij për shkak të ngarkesës së madhe të punës, nuk ka planifikuar akoma gjykimin e saj.

Në këto kushte dhe rrethana duke e analizuar dhe vlerësuar problemin në fjalë në prizmin e mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut, sipas parashikimeve të kërkesave të nenit 42/2 të Kushtetutës së RSH, dhe të kërkesat nenit 6/1 të KEDNJ, "Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm.

Në rastin konkret mendojmë ka vend të studjohen hapësirat ligjore dhe nga ana juaj dhe të merren masa tekniko-organizative për shpejtimin e gjykimit të kësaj çështje duke patur parasysh edhe disa fakte të tjera, si moshë 67 vjeç e tij, se ai është i martuar me shumë fëmijë dhe ndodhet në një gjendje shëndësore dhe ekonomike jo të mirë, kohën e gjatë që ka kaluar, nga gjykimi etj.

Në nenin 2 të Ligjit me Nr.49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor, brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjëvënësimit në krijimi e këtyregjykatave. Libgji synon thjeshtimin e procedurave me object zgjidhjen e mosmarrveshjeve administrative dhe se qëllimi iu krijimit të gjykatave administrative ishte garantimi i mbrojtjes së të drejtave e

subjekteve dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor, dhe brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Në nenin 63,3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se:

'Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave, dhe lirive të Njeriut, nga administrata publike', dhe kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 0-4.02.1999"Për Avokatin e Popullit", ku përcaktohet se:

"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen", dhe ju

REKOMANDIMË :

1.Marrjen e masave organizative për planifikimin e caktimit të gjyqësorit të çështjes administrative, të shtetasit Q. M., Regjistruar për gjykim në atë Gjykatë, me dt.29.09.2016.

2. Mbi masat e marra nga ana juaj, dhe zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI